

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 14 PRILL 2022

Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë,

E nderuar Kryetare,

Qëllimi kryesor i Entit Rregullator të Ujësjes, në bazë të ligjit, është të mbrojë interesat publike dhe ligjore në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët. Me gjithë vlerësimin profesional ndaj drejtuesit të këtij institucioni, raporti nuk tregon gjendjen reale dhe fsheh problemet shqetësuese të furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët shqiptarë, normalisht, kjo jo për faj të tij. Edi Rama, në fushatën elektorale të vitit 2013-të, ndër shumë premtime me të cilat u mori votat shqiptarëve dha edhe premtimin që brenda mandatit 4-vjeçar çdo familje do të kishte ujë të pijshëm dhe çdo parcelë do të kishte ujë vaditës. Kaluan 4 vjet, madje kaluan 8 vjet, po kalon edhe viti i nëntë dhe Edi Rama nuk e ka mbajtur premtimin. Madje, edhe në fushatën e vitit 2021 ky ishte një ndër premtimet dhe akoma nuk po zbatohet, premtim ky që bëhet pas dy mandateve qeverisjeje, kur vendet e tjera me shumë më pak burime ujore e kanë tejkaluar me kohë këtë standard që ne kemi sot në Shqipëri.

Edi Rama dhe qeveria e tij mashtruan shqiptarët sa për t'u marrë votat dhe nuk e mbajtën premtimin dhe shumicën e premtimeve që nga viti 2013. Para janë dhënë me shumicë për sektorin e ujit; miliona euro të hedhura kot, por ujë nuk ka. Pjesa më e madhe e fondeve janë bërë pre e tenderëve korruptivë dhe investimeve joeficiente, që e kanë lënë krejtësisht të amortizuar këtë sektor jetik. Enti Rregullator i Ujësjes nuk është në një situatë komode. Faktet tregojnë se ERRU-ja nuk e ka luajtur rolin e saj ndër vite në disa drejtime. Miratimi i tarifës së ujit në shumicën e rasteve nuk respekton koston reale, por vendoset sipas oreksit të ujësjes apo të bashkive përkatëse. Shembulli tipik është ujësjesi i Tiranës, ku në 13 vjetët e fundit është katërfishuar tarifa e ujit, pra një tarifë jo në bazë të koston. Kemi një disproporcion sot në Shqipëri, ku një pjesë e qytetarëve dhe bashkive furnizohen 24 orë me ujë e një pjesë tjetër furnizohen me 30 minuta apo nuk kanë fare ujë.

Problematikat e konstatuara për ujin

Mbulimi me ujë

Kemi një përkeqësim të furnizimit me ujë. Nga 79% në vitin 2016, në vitin 2021 është vetëm 77%, madje kjo është një shifër e fryrë. Mjafton të sjellim në vëmendje Bashkinë e Dibrës, ku kemi një situatë katastrofike. Vetëm 30 minuta furnizohet qyteti me ujë dhe në të gjitha ish-njësitë vendore mjaftojnë çezmat publike të fshatit.

Mbulimi me kanalizime

Mbulimi me kanalizime është vetëm 51,9%. Jemi përballë një situatë katastrofike. Mjafton të shohësh kryeqytetin, ku lumi Lana kalon në mes të kryeqytetit dhe ujërat e zeza që derdhen në të shërbejnë si “parfum” për qytetarët. Në Tiranë nuk ka një impiant të përpunimit të ujërave të zeza, edhe pse kishim një financim të qeverisë japoneze ose JACA-s, që duhet të kishte mbaruar që para 2-3 vjetësh. Ky projekt nuk funksionon, madje ka 7 vjet që është ndaluar nga kjo qeveri në mënyrë korruptive dhe pritët të ketë dhe një tjetër faturë të majme nga arbitrazhi ndërkombëtar, për shkak të bllokimit të njëanshëm dhe pa arsye të këtij investimi strategjik për qytetin e Tiranës.

#### Mbulimi i kostove operative dhe të mirëmbajtjes

Kemi një përkeqësim të frikshëm të kostove operative për shkak të rritjes së energjisë elektrike, për shkak të abuzimeve. Vetëm 75% e kostos totale mbulohet nga të ardhurat e ndërmarrjeve. Sikur të mos mjaftojë kjo, këtë vit do të përkeqësohet edhe më tej, pasi Enti Rregullator i Energjisë Elektrike nuk do ta japë energjinë si më parë, por ujësjellësit do ta marrin energjinë në tregun e liberalizuar, pra me tarifa 3 herë më të larta se sot. E thënë troç, do të rritet më tej kostoja e furnizimit me ujë.

#### Norma e arkëtimit

Këtu kemi një shifër skandaloze. Vetëm 76% e ujit të faturuar arkëtohet sot. Humbja e ujit është në shifra marramendëse. 65% e ujit nuk arkëtohet, nuk faturohet, pra është një shifër rekord, si në asnjë vend tjetër jo vetëm të Europës, por dhe të Ballkanit e më gjerë.

#### Eficienca e stafit

Në vitin 2021 kemi një shifër marramendëse me 5,3 punonjës për 1000 lidhje, 2 herë më shumë se mesatarja e Europës. Kjo ka ardhur vetëm për një arsye: sepse nuk punësohen profesionistë, nuk punësohen njerëz që punojnë, por punësohen njerëz me prapavijë politike, që madje shërbejnë edhe si patronazhistë sa herë zhvillohen zgjedhjet.

#### Kohëzgjatja e furnizimit me ujë

Ky është një tjetër argument për të treguar se, pavarësisht se u premtua që do të ketë ujë në çdo familje dhe ujë 24 orë, në 9 vjet është rritur afërsisht vetëm 1 orë furnizimi me ujë, pavarësisht se janë miliona euro të marra borxh nga buxheti i shtetit, pra hua të huaja për ujësjellësit apo investime të tjera të bëra nga buxheti i shtetit. Dështim total i qeverisë! Në buletin e ERRU-së thuhet që Kamza furnizohet 24 orë me ujë, pra edhe buletini nuk është koherent, por, në fakt, në Kamëz kemi një pjesë të konsiderueshme të qytetareve që nuk furnizohen asnjë sekondë me ujë, sepse akoma nuk ka mbaruar faza e dytë e këtij projekti, pavarësisht se duhet të kishte filluar dhe faza e tretë. Pra, vazhdojmë të kemi probleme me furnizimin me ujë dhe në qytete pranë kryeqytetit të Shqipërisë. Standardi i vendeve të botës së tretë vazhdon të ekzistojë sidomos në qarkun e Dibrës apo në mjaft zona të tjera.

#### Investimet e diferencuara

Shqetësues ngelet disproporcioni i standardeve ndërmjet ujësjellësve të ndryshëm. Kemi ndërmarrje të ujësjellësve me standarde bashkëkohore në qytete, si: Korça, Lezha, Erseka, Saranda, Pogradeci e të

tjera, që jo vetëm janë ndihmuar nga kreditë, por madje nuk paguhen dhe interesat për këto kredi nga ujësjellësit, duke përjashtuar këtu Lezhën. Pra, kjo do të thotë se për këto ndërmarrje do të paguajnë dhe banorët e qyteteve që nuk kanë ujë për të pirë. Është vërtet skandaloze se si qytetarët e Dibrës, të Tropojës, të Matit, të Librazhdit, të Skraparit, të Devollit e të mjaft qyteteve të tjera duhet të paguajnë për kostot e qyteteve që ndoshta furnizohen me ujë 24 orë.

Të nderuar kolegë,

Enti Rregullator i Ujësjellësit duhet të luajë rolin e krijimit të standardeve unike, me ndikimin të qeveria për të bërë investime ekstensive në bashkitë pa ujë ose pa investime, për të zvogëluar diferencat e furnizimit me ujë në qytete të ndryshme; duhet të ndikojë në hartimin e projekteve të unifikuara sipas buletinit të çmimeve dhe jo në emetimin e projekteve korruptive si ato të AKUM-it në vitet 2020-2021, që më shumë ishin elektorale, totalisht korruptive dhe pa asnjë efekt në rritjen e orarit të furnizimit me ujë të pijshëm. Qeveria e rilindjes, në bashkëpunim dhe me ERRU-në, synon të krijojë artificialisht ekonominë e shkallës. Jam për rajonalizimin dhe për ekonominë e shkallës, por nuk mundet të kemi rajonalizim kur një qytet nuk ka ujë 24 orë dhe kur një qytet tjetër nuk ka fare furnizim me ujë, madje as 30 minuta. Kjo do të ndikojë negativisht në krijimin e hendekut ndërmjet qyteteve të ndryshme të Shqipërisë. Ndaj kërkohet me ngulm që çdo qytet, pavarësisht pozicionit gjeografik apo bindjeve të politikës së shumicës së asaj zone, të jetë prioritet i qeverisë, për të unifikuar standardin e furnizimit me ujë.

Enti Rregullator i Ujësjellësit, si një institucion i pavarur dhe kryesor në sektorin e ujësjellësit, duhet të ngrrejë alarmin dhe të transmetojë jo vetëm tek operatorët e ujësjellësit, por edhe te qeveria shqiptare rekomandime konkrete dhe bashkëkohore për standarde si të Bashkimit Europian: hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore për rritjen e garancisë së sigurisë së shëndetit publik, uljen e riskut të kontaminimit të rrjeteve të shpërndarjes; uljen e numrit të punonjësve në raport me njëmijë lidhje dhe të shumë standardeve të tjera të vendeve të Bashkimit Europian. Politika duhet të heqë duart nga punësimet në ujësjellës. Rritja e numrit të punësuarve politikë, e patronazhistëve jashtë kriterëve, rritja e shpenzimeve operative dhe luksi, rritja e çmimit të energjisë elektrike për ujësjellësin, investimet elektorale dhe korruptive janë indikatorë kryesorë të rritjes së çmimit të ujit të pijshëm dhe situatës ekonomiko-financiare të ujësjellësve. Shqipëria mundet të ketë 24 orë ujë, por që kjo të ndodhë duhet t'i jepet fund abuzimit, korrupsionit, diferencave politike dhe punësimeve partiake që paguhen me taksat e qytetarëve. Ujë ka, por, si çdo gjë, vidhet dhe abuzohet me të. Faleminderit!